



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO  
KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pratje / Attachment Priloge / Enclosure Priloge / Enclosure	25.06.2021	with and year	
Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Pratje No	Shtesa Priloge Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHIK	3314/2021		116



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.457/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit numër A.nr.2816/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 25.05.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.634/2019 të datës 17.10.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Gazmend Zajmi", hyrja 1/3, kati III, Nr.11, Komuna e Prishtinës, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "masë disiplinore-ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 25.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.634/2019 e datës 17.10.2019 e parashtruar nga ankuesi
- III. Shfuqizohet** Vendimi i datës 02.09.2019 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Prishtinës i protokolluar me numër: 14-116/01-214627/19.
- IV. Obligohet** Kryetari i Komunës së Prishtinës që ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës, sipas Akt Emërimit të datës 13.06.2014 me numër 01-112-536 me të gjitha të drejtat dhe detyrat që burojnë nga marrëdhënia e punës si dhe t'i bëjë **kompensimin e të gjitha pagave** prej momentit të largimit deri në ditën e kthimit të tij në vendin e punës.
- V. Obligohet** Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditore nga dita e pranimit të tij.
- VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi sipas akt emërimit të datës 13.06.2014 me numër 01-112-536 i sistemuar në vendin e punës “Përfaqësues Juridik i Komunës”, Njësia: Zyra për përfaqësime juridike të Komunës së Prishtinës. Ndaj ankuesit Kryetari i Komunës së Prishtinës ne datë 02.08.2019 me numër të protokollit 14-116/01-189477/19 ka raportuar për shkelje të supozuar disiplinore e kryer nga ankuesi me arsyetim se: *“I njëjti ka bërë shkelje të rënda disiplinore duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.10, 1.15 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil”*.

Komisioni Disiplinor me datë 02.09.2019 nxjerr vendimin i cili është protokolluar me numër 14-116/01-214627/19, me të cilin vendim ankuesit i shqiptohet masa disiplinore *“ndërprerje e marrëdhënia e punës”*, me arsyetimin se ankuesi ka bërë shkelje të rënda disiplinore duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.10, 1.15 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil pasi që nuk ka ndërmarr veprimet e nevojshme juridike si përfaqësues juridik i komunës lidhur me njoftimin Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 18.06.2018 me shifër PPP.nr.311/18, njoftim i cili nga komuna është pranuar me datë 26.06.2021.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 02.09.2019 me numër 14-116/01-214627/19, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 14-070/01-0219617/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës me datë 06.09.2021

Ankuesi për shkak të heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, brenda afatit kohor siç përcaktohet me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 17.10.2019 parashtron ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 4893/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë me datë 23.10.2019 tek Komuna e Prishtinës. Ndërsa Komuna e Prishtinës me datë 31.12.2020 përmes e-maili e ka dërguar në Këshill përgjigjen jo të plotë në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës e protokolluar me numër 3370/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 21.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 25.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2816/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 22.11.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 17.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit e datës 17.10.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër

14-116/01-214627/19 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës datës 02.09.2019; Ankesën e ankuesit e datës 06.09.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, Formularin e datës 06.09.2019 të parashtrimit të ankesës; Kërkesën e datës 10.10.2019 parashtruar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës; Formularin e datës 10.10.2019 të parashtrimit të kërkesës; Shkresën përcjellëse të datës 26.06.2019 me numër:522 dërguar nga ankuesi për Drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit të Komunës së Prishtinës; Njoftimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 18.06.2018 me shifër PPP.nr.311/18; Fletëkthesa e pranimit të shkresë e datës 25.06.2018; vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës të datës 27.08.2013; Urdhëron e përmbaruesit privat të datës 03.02.2017; Propozimin për përmbarim të datës 02.02.2017; E-mailin e datës 27.02.2017 dërguar nga E-mailin e datës 06.03.2017 dërguar nga për Shkresën e datës 04.02.2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.10.2019, Përgjigjen në kërkesë të datës 31.12.2020; Akt-emërimin e ankuesit të datës 13.06.2014; Formularin e raportimit të shkeljes disiplinore të datës 02.08.2019; Fletë dorëzimin e datës 30.08.2019; Vendimin për formimin e komisionit disiplinor i datës 16.05.2018; Akt-emërimin e datës 01.02.2017 për Akt-emërimin e datës 01.02.2017 për Akt-emërimin e datës 01.02.2017 për Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 24.07.2019; Procesverbalin e datës 02.09.2019 të Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 17.12.2020 dërguar nga zyrtari i KPMSHCK-së për komunën e Prishtinës-Udhëheqësin e Njësisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 21.11.2019; Aktgjykimin numër A.nr.2816/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 25.05.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është, **e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës” ndaj tij, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me Rregulloren Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore të Shërbimit Civil pasi që nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komisioni disiplinor i Komunës së Prishtinës me nxjerrjen e vendimit të datës 02.09.2019 i cili është protokolluar me numër:14-116/01-214627/19, ankuesit shqiptohet masa disiplinore “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*” në Shërbimin Civil, pasi që i njëjti nuk ka vepruar në pajtim me detyrat e punës duke mos vepruar sipas njoftimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 18.06.2018 me shifër PPP.nr.311/18 njoftim i cili ishte pranuar nga ankuesi me datë 26.06.2019.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 87 paragrafi 1 i cili përcakton se: “*Nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me vepër penale, siç është përcaktuar me këtë ligj.*” si dhe neni 66 paragrafi 1 dhe 2, i të njëjtit ligj cilët përcaktojnë se: “*1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor*” si dhe “*2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda – serioze të cilat do të rregullohen me akt nënligjor*” si dhe dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 i cili përcaktojnë se: “*dështimi i deklarimit ose dhënia e deklaratës të rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit*”, si dhe neni 8 paragrafi 1, nënparagrafët 1.4 i të njëjtës rregulloreje të cilët përcaktojnë se: 1.4 *ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni*

*disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension”, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit “ndërprerje e marrëdhënies së punës” është masa më e rëndë që shqiptohet në Shërbimin Civil.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prishtinës me datë 02.08.2019 ka kërkuar inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit në Komisionin Disiplinor për shkelje të rënda disiplinore, ndërsa Komisioni Disiplinor në bazë të procesverbalit të seancës disiplinore të datës 02.09.2019 ka nxjerr vendimin me numër 14-116/01-214627/19 ku edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës ankuesit, andaj me këtë rast Komisioni Disiplinor e datës 02.09.2019 me numër 14-116/01-214627/19 e ka marrë në kundërshtim me dispozitat e Rregulloren Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore të Shërbimit Civil neni 14 paragrafi 4 i cili përcakton se: *“Faktet dhe dëshmitë për seanca disiplinore duhet të kompletohet sa më shpejt që është e mundur dhe komisioni duhet të marrë vendim brenda (30) ditëve prej lajmërimit të rastit”,* pasi që vendimi është marrë në ditën e (32) nga lajmërimi i rastit, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankuesit është i bazuar ndërsa vendimi i Komisionit i Komisionit Disiplinor i datës 02.09.2019 është nxjerrë në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 i cili përcakton se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është në kundërshtim me ligjin material”* si dhe në kundërshtim me neni 78 paragrafi 1 i të njëjtit ligj i cili përcakton se: *“Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët (në vijim: “afati procedural”), përcaktohen nga ligji apo akti nënligjor”* dhe si i tillë nuk prodhon asnjë pasojë juridike për ankuesin pasi që si i tillë është nxjerrë në kundërshtim me afatet e përcaktuara kohore të përcaktuara me dispozitat e lartcekura, dhe mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi siç e ka deklaruar edhe në ankesën e tij, Njoftimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 18.06.2018 me shifër PPP.nr.311/18 e ka pranuar me datë 26.06.2019, mirëpo në të njëjtën ditë me datë 26.06.2018 me akt përcjellës numr:522, Njoftimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 18.06.2018 me shifër PPP.nr.311/18 e ka përcjell tek Drejtori i Drejtorisë së Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pasi që në Njoftimin të datës 18.06.2018 me shifër PPP.nr.311/18 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me mënyrë decidive e ka ftuar, citoj: *“FTON debitorin Komuna e Prishtinës-Drejtoria për kadastrë dhe pronë që brenda afatit prej 7 ditësh të deklarohet lidhur me propozimin e përmbaruesit Privat...”,* andaj me këtë rast ankuesi ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 51 paragrafi 1 i cili përcakton se: *“Nëpunësit civilë i ushtrojnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës”,* pasi që shkresën-njoftimin në fjalë e ka përcjell pa vonesë tek Drejtori i Drejtorisë përkatëse, dhe përkundër kësaj ankuesi nuk ka pranuar asnjë kërkesë nga Drejtori i Drejtorisë për Kadastrë dhe Pronë për ndërmarrjen e ndonjë veprimi procedural lidhur me njoftimin në fjalë, madje institucioni punëdhënës në këtë rast Komuna e Prishtinës me rastin e përgjigjes në kërkesë të datës 31.12.2020 nuk ka sjellë asnjë provë që dëshmojnë një gjë të tillë.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër: 14-116/01-214627/19 të datës 02.09.2019 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës” e cila vlerësohet si masa më e rëndë që shqiptohet në shërbimin civil ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 66 paragrafi 1 i cili përcakton se: *“1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor”,* pasi që Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj

ankuesit nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike pasi që ka zhveshur nga përgjegjësia drejtorin e Drejtorisë për Kadastër dhe Pronë apo zyrtarët përgjegjës të kësaj drejtorie të cilët nuk ka kanë ndërmarr asnjë veprim apo kërkesë ndaj ankuesit dhe madje as vetë Kryetarin e Komunës nuk e ka informuar në cilësi të eprorit, se si të vepronë për rastin në fjalë, dhe po ashtu në bazë të provave të sëlluar me datë 31.12.2020 Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të dëshmojë me asnjë provë se ankuesi më herët ka pasur ndonjë vërejtje apo masë të shqiptuar disiplinore, po ashtu masa disiplinore “*ndërprerja e marrëdhënies së punës*” nuk është masa e vetme që mundet apo duhet t’i shqiptohet nëpunësit civil nga Komisioni Disiplinor pasi që edhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 8 paragrafi 2 i cili përcakton se: “*Në përcaktimin e masave adekuate, komisioni duhet të ketë parasysh se qëllimi i procedurës disiplinore është të përmirësojë dhe inkurajojë sjellje të mirë dhe të dënojë sjelljen jo të mirë*”, nga rrjedh se komisioni disiplinor në rastin konkret i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore më të rëndë në shërbimin civil, qëllimi i së cilës nuk ka qenë inkurajimi apo përmirësimi i sjelljes.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës dhe çështjeve të evidentuara më lart në këtë vendim, ka konstatuar se Vendimi i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës më numër: 14-116/01-214627/19 i datës 02.09.2019 është nxjerr në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 i cili përcakton se: “*Akti administrativ i shkruar përmban: pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin)*” nenin 48 paragrafi 1 paragrafi 1.4 i cili përcakton se: “*1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret*”, nenin 48 paragrafi 2 i të njëjtit ligj i cili përcakton se: “*Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*”, andaj si i tillë Vendimi i Komisionit Disiplinor është i paligjshëm dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik siç e përcaktojnë dispozitat Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4; 1.5 dhe 1.6 i cili përcakton se: “*Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6 është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme*”, se ka pas konstatim të gabueshëm të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe është shkelur Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, janë të plotësisht qëndrueshme dhe të bazuara.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se Komuna e Prishtinës nuk ka vepruar në pajtueshmëri të plotë siç obligohet me nenin 26 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton se: “*Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin*”, pasi që në kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.10.2019 janë përngjitur tek pas më shumë se një (1) viti me datë 31.12.2020, dhe po ashtu provat e bashkangjitura në përgjigjen e dërguar përmes e-mailin me nuk kanë qenë të plotë siç janë kërkuar paraprakisht.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës me rastin e mos shqyrtimit të ankesë së ankuesit të datës 06.09.2019 të ankuesit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka përmbushur detyrimet ligjore që ka lidhur me trajtimin e ankesave të shërbyesve civil.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: “*Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe*

zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: “Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.457/2021**

**Flakron GASHI**



*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

